



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E ARSIMIT

PROJEKT VENDIM

Nr. Datë . 07 . 2025

**"PËR MIRATIMIN E PLANIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TË
BASHKISË KOLONJË "**

Këshilli i Bashkisë Kolonë pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, bazuar në nenin 8 pika 2, nenin 9 pika 1/1.1 gërma "b", nenin 23 pika 12, neni 24 pika 1, nenin 54 gërma "k", neni 55 pikat 2 dhe 6 të Ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshillit Bashkiak në mbledhjen e datës 17.07.2025.

PROPOZOJ:

1. Të miratojë planin e arsimit parauniversitar të bashkisë Kolonjë për vitin 2025-2028 , bashkëngjitur këtij dokumenti.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria Ekonomike e Finacës dhe Buxhetit .
3. Ky vendim hyn ne fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

KRYETARI

ERION ISAI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E ARSIMIT

Nr 3470 Prot

Ersekë, më 11.7.2025

RELACION
PËR
PROJEKT VENDIM

Nr. Datë .07 . 2025

**"PËR MIRATIMIN E PLANIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TË
BASHKISË KOLONJË "**

Të nderuar Këshilltarë !

Bazuar në nenin 8 pika 2, nenin 9 pika 1/1.1 gërma "b", nenin 23 pika 12, neni 24 pika 1, nenin 54 gërma "k", neni 55 pikat 2 dhe 6 të Ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, propozojmë të miratohet nga Këshilli Bashkiak, "Plani i arsimit parauniversitar" në Bashkinë Kolonjë.

Qëllimi i këtij plani është të vijoje të shërbeje si një platformë strategjike dhe gjithëpërfshirëse që synon një zhvillim të qëndrueshëm dhe cilësor për të gjitha strukturat e arsimit, i cili konsiderohet si një nga sektorët me impakt të drejtpërdrejtë në mirëqënien sociale dhe ekonomike të Bashkisë Kolonjë.

Plani që propozojmë, do të vijoje të luajë një rol të rëndësishëm për Bashkinë Kolonjë, drejt rritjes së cilësisë së shërbimit të arsimit dhe konsolidimit të standardeve të tij.

Qëllimi i këtij plani është të përmirësojë cilësinë e arsimit në Bashkinë Kolonjë, duke përfshirë përmirësimin e infrastrukturës së IA, të sigurojmë për çdo fëmijë në territorin e Bashkisë Kolonjë akses në arsim parauniversitar gjithëpërfshirës, cilësor dhe të drejtë, të zhvilluar në mjedise të sigurta e të përshtatshme, me mësues të përgatitur dhe mbështetje të vazhdueshme, duke e trajtuar arsimin si një shtyllë themelore për zhvillimin social dhe ekonomik të komunitetit, forcimin e barazisë dhe pjesëmarrjen aktive në jetën shoqërore dhe institucionale

Dokumenti gjithashtu përfshin një analizë përmbajtësore e cila përfshin Vizionin, Misionin, dhe Objektivat Strategjike të Planit, duke përcaktuar gjithashtu personat përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e tij.

Pjesa e dytë e dokumentit fokusohet në vendosjen e objektivave specifike për secilin proces, ndërkohë që në pjesën e tretë, paraqitet buxheti i nevojshëm për të realizuar ndërhyrjet në terren për rritjen e cilësisë së arsimit parauniversitar.

Plani ka edhe një aneks dedikuar treguesve të performancës për t'u përdorur për monitorimin e tij në vitet që vijnë.

Plani do të shërbejë për të gjitha kopshtet dhe shkollat nën juridiksionin e Bashkisë Kolonjë dhe do të monitorohet nga Drejtoria e Arsimit në bashki dhe ZVAP Kolonjë, me qëllim përmirësimin e shërbimeve arsimore për të gjithë fëmijët dhe nxënësit në këtë bashki.

Plani i arsimit parauniversitar në Bashkinë Kolonjë, përqendrohet në Proceset e Menaxhimit të shërbimit në arsimin, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe organizimit efektiv. Planifikimi dhe kontrolli i cilësisë janë thelbësore për këtë qëllim, duke përfshirë planifikimin e numrit të fëmijëve/ nxënësve në IA dhe vlerësimin e infrastrukturës së nevojshme.

Objektivat kryesore të planit përfshijnë kryesisht rikonstruksione të IA-ve me qëllim përmirësimin e kushteve të mësimdhënies dhe mësimnxënies në çerdhe, kopshte dhe shkolla dhe më pas një rëndësi e veçantë i është kushtuar edhe minimizimit të braktisjes shkollore dhe orientimit të nxënësve drejt arsimit profesional. Gjithashtu në fokus është edhe vemendja e shtuar që do të kushtohet fëmijëve/nxënësve që vijnë nga familjet në nevojë duke u krijuar mbështetje si dhe mundësi për përfshirje në programe edukative dhe sociale plotësuese.

Për një periudhë dy vjeçare, Plani prezanton sfidat dhe mundësitë specifike, duke përfshirë nevojën për të identifikuar nevojat e komunitetit dhe për të përdorur teknologjinë për të përmirësuar menaxhimin e të dhënave.

Plani synon të adresojë edhe Proceset Kryesore të përmirësimit të shërbimit për fëmijët në nevojë për përfshirje sociale, mbrojtje dhe ata me aftësi ndryshe në IA publike të Bashkisë Kolonjë.

Përmes një planifikimi cilësor, pritet të rritet identifikimi, vlerësimi dhe trajtimi më i mirë i këtyre rasteve në mënyrë që të sigurohet një shërbim cilësor dhe i plotë për fëmijët në nevojë.

Për të arritur këtë qëllim, plani ka disa objektiva të përgjithshëm, si rritja e identifikimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale, mbrojtje dhe me aftësi të kufizuara, si dhe përmirësimi i procesit të menaxhimit të këtyre rasteve.

Përveç kësaj, synohet edhe hartimi dhe zbatimi i politikave të mbrojtjes së fëmijëve në institucionet arsimore dhe përmirësimi i bashkëpunimit mes strukturave të shërbimit social të përfshira për të garantuar një trajtim të drejtë dhe të efektshëm për të gjithë fëmijët në nevojë.

Planifikimi dhe zbatimi i Proceseve Mbështetëse në Planin e Arsimit Parauniversitar për institucionet arsimore publike të Bashkisë Kolonjë, është një pjesë kritike e përpjekjeve për të siguruar një mjedis të përshtatshëm dhe cilësor për fëmijët dhe nxënësit. Këto procese janë themelore për arritjen e qëllimeve të përcaktuara, duke përfshirë trajnimin e stafit, përmirësimin e infrastrukturës së kopshteve/shkollave dhe sigurimin e materialeve të nevojshme. Qëllimi i Proceseve Mbështetëse është të ofrojnë mbështetje efektive për proceset kryesore të shërbimit në IA. Këto përfshijnë aspekte të rëndësishme si edukimi, siguria, zhvillimi dhe aksesueshmëria për të gjithë fëmijët dhe nxënësit.

Për të arritur këtë qëllim, objektivat kryesore përfshijnë plotësimin e standardeve të vendosura nga ligji për stafin e IA, rikonstruksionin/mirembajtjen periodike të godinave për të përmirësuar infrastrukturën dhe sigurimin e materialeve bazë për të përmbushur nevojat e zhvillimit të nxënësve.

Për rikonstrukcionin e godinave, janë identifikuar nevojat konkrete të kopshteve dhe shkollave, konviktin duke përfshirë rikonstrukcionin dhe /ose rinovimin/mirëmbajtjen e ambienteve të brendshme dhe të jashtme.

Për të realizuar të gjitha projektet e përfshira në Planin e Arsimit Parauniversitar, nevojitet buxheti përkatësisht: **36,602 mijë lekësh**.

Përmbledhje e investimeve kapitale (2025–2028)

Plani i investimeve kapitale për përmirësimin e arsimit parauniversitar në Bashkinë Kolonjë për periudhën 2025–2028 parashikon një kërkesë financiare totale prej **36,602 mijë lekësh**. Kryesisht, ndërhyrjet do të fokusohen në:

- **Rikonstrukcionin e ambjenteve dhe terreneve sportive**, me synim krijimin e hapësirave të sigurta dhe funksionale për aktivitet fizik dhe socializim të nxënësve;
- **Hapjen e një kopshti me shërbim ushqimi (drekë)** për të zgjeruar aksesin dhe përkujdesjen ndaj fëmijëve të moshës parashkollore.
- **Rikonstrukcionin e konviktit të nxënësve në Ersekë**, për të siguruar kushte jetese dinjitoze për fëmijët që ndjekin shkollën larg vendbanimit.

Mbështetur në nenin 8 pika 2, nenin 9 pika 1/1.1 gërma “b”, nenin 23 pika 12, neni 24 pika 1, nenin 54 gërma “k”, neni 55 pikat 2 dhe 6 të Ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar,, paraqesim projekt vendimin për shqyrtimin dhe miratimin e “Planit të Arsimit Parauniversitar të bashkisë Kolonjë”.

Konc: Drejtor Arsimit M.Vivo


Konfirmoi: Drejtori D.Ç.J.P.P.O.Lifo





BASHKIA KOLONJË

PLANI I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR BASHKIA KOLONJË



2025 - 2028

1. Hyrje dhe konteksti.....	6
Konteksti administrativ	6
Të dhëna demografike.....	6
Kuari ligjor dhe politika që përcakton bazën referuese për detyrat dhe përgjegjësitë në fushën e arsimit në nivel vendor	8
2. Analiza e shërbimit të arsimit parashkollor në vitin shkollor 2024 – 2025	9
Mbulimi i ofrimit të shërbimit të arsimit parashkollor 0000	9
Frekuentimi në kopshte	9
3. Analiza e shërbimit të arsimit në shkolla bazë dhe atij të mesëm në vitin shkollor 2024 – 2025	10
Mbulimi i ofrimit të shërbimit të arsimit.....	10
Frekuentimi në arsimin fillor	11
Frekuentimi arsimi 9-vjecar.....	12
Frekuentimi arsimi i mesëm	12
4. Shërbimi i Arsimit sipas njësive administrative.....	13
Njësia Administrative: Ersekë	13
Kopshtet	13
Shkollat	13
Konvikti për nxënësit në Ersekë.....	13
Njësia Administrative: Qendër Ersekë.....	14
Kopshtet	14
Shkollat	14
Njësia Administrative: Barmash	14
Kopshtet	14
Shkollat	14
Njësia Administrative: Mollas	15
Kopshtet	15
Shkollat	15
Njësia Administrative: Leskovik	16
Kopshtet	16
Shkollat	16
5. Vizioni, Qëllimet Strategjike, Objektivat dhe përmbledhja e ndërhyrjeve për përmirësimin e Arsimit Parauniversitar	17
Vizioni	17
Përmbledhje e Qëllimeve, Objektiveve dhe Aktiviteteve.....	17
Përmbledhje e investimeve kapitale (2025–2028).....	18
6. Planifikimi afatmesëm buxhetor i shërbimit të Arsimit parauniversitar	20

Të ardhurat vendore dhe transferimet nga qeveria qendrore për shërbimin e arsimit parauniversitar	20
7. Plani i Veprimit (matrica e aktiviteteve).....	22
8. Plani i investimeve kapitale	30
9. Monitorimi dhe vlerësimi.....	31
Indikatorët e Performancës	31
Planifikimi i vlerësimit të progresit	31
Përfshirja e aktorëve të jashtëm	31
Metodologjia e monitorimit dhe vlerësimi	31
Monitorimi i realizimit të aktiviteteve	31
Vlerësimi i ndikimit në komunitet	32
10. Rishikimi dhe përshtatja e planit.....	32
Procesi i rishikimit	32
Përshtatja e masave dhe aktiviteteve.....	33
11. Raportimi dhe transparenca	33
12. Aneks 1: Kuadri Ligjor dhe nënligjor për Arsimin Parauniversitar	34

Parathënie

Bashkia Kolonjë, në përputhje me vizionin e saj për të ndërtuar një komunitet të qëndrueshëm, të drejtë dhe të zhvilluar, i kushton vëmendje të veçantë arsimit si një shtyllë themelore për të ardhmen e fëmijëve dhe të vetë zhvillimit shoqëror. Përkushtimi ynë ndaj një arsimi cilësor, gjithëpërfshirës dhe të aksesueshëm për çdo fëmijë reflektohet qartë në këtë **Plan të Arsimit Parauniversitar 2025–2028**.

Ky plan është ndërtuar mbi tri shtylla kryesore:

- **Sigurimi i një mjedisi arsimor të sigurt, funksional dhe gjithëpërfshirës**, nëpërmjet investimeve në infrastrukturë, përmirësimit të kushteve higjieno-sanitare, pajisjes me mjete didaktike dhe funksionimit të shërbimeve mbështetëse;
- **Zhvillimi i plotë i fëmijëve**, përmes përkujdesjes së integruar, fuqizimit të kapaciteteve të stafit edukues dhe garantimit të mbështetjes për fëmijët në nevojë apo me aftësi të veçanta;
- **Nxitja e pjesëmarrjes, talentit dhe ndjesisë së përkatësisë**, përmes veprimtarive edukative, kulturore dhe ndërgjegjëse të zhvilluara gjatë gjithë vitit shkollor.

Në bashkëpunim me institucionet arsimore, komunitetin lokal, prindërit dhe partnerët e zhvillimit, Bashkia Kolonjë synon të garantojë një sistem arsimor që i përgjigjet standardeve bashkëkohore dhe nevojave konkrete të çdo fëmije, pa përjashtim.

Ky plan është hartuar me përkushtim dhe profesionalizëm, duke u mbështetur në të dhëna konkrete, standarde kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe në konsultime me aktorët lokalë. Zbatimi i tij do të kërkojë angazhim të vazhdueshëm, bashkëpunim të ndërsjellë dhe monitorim të kujdesshëm për të siguruar një ndikim pozitiv dhe afatgjatë.

Bashkia Kolonjë rikonfirmon angazhimin e saj të palëkundur për t'i ofruar çdo fëmije një arsimit dinjitoz, të drejtë dhe të barabartë, si themel për zhvillimin e tij personal dhe për të ardhmen e komunitetit tonë.

Me respekt,

Erion Isai

Kryetar i Bashkisë Kolonjë

Falënderime

Bashkia Kolonjë shpreh mirënjohjen e saj të veçantë për të gjithë ata që kontribuan në hartimin e Planit të Arsimit Parauniversitar 2026–2028. Ky proces është realizuar me mbështetjen e Shoqatës Kombëtare të bashkive të Shqipërisë dhe me ekspertizën teknike të “Smart Processes”, të cilët lehtësuan analizën, planifikimin dhe ndërtimin metodologjik të këtij dokumenti strategjik vendor.

Falënderojmë në mënyrë të veçantë angazhimin e Këshillit Bashkiak të Kolonjës, për mbështetjen e dhënë gjatë gjithë procesit, si dhe për angazhimin e strukturave të tij në sigurimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe transparente.

Gjithashtu, vlerësojmë kontributin e drejtuesve të bashkisë, përfaqësuesve të drejtorive dhe sektorëve vendorë të arsimit, financave, infrastrukturës, shërbimeve sociale, si dhe drejtuesve të institucioneve arsimore, edukatorëve dhe mësuesve që ofruan informacion të vlefshëm dhe reflektim mbi nevojat reale në terren.

Mirënjohje shkon edhe për organizatat e shoqërisë civile, këshillat e prindërve, grupet komunitare dhe partnerët lokalë, të cilët morën pjesë në takime konsultative dhe ndihmuan në pasqyrimin e realitetit arsimor dhe prioritetëve të komunitetit.

Ky plan përfaqëson një vullnet të përbashkët për të ndërtuar një sistem arsimor më të mirë për çdo fëmijë në territorin e Bashkisë Kolonjë..

1. Hyrje dhe konteksti

Konteksti administrativ

Bashkia Kolonjë përfshin një numër njësisish administrative, secila prej të cilave luan një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve publike për komunitetin lokal, përfshirë edhe shërbimet e arsimit parashkollor.

Kjo Bashki e përbërë nga 8 njësi administrative përbëhet nga një ndërthurje e zonave urbane dhe rurale, çka ndikon ndjeshëm në mënyrën e organizimit të shërbimeve publike, si dhe në shpërndarjen e burimeve njerëzore, infrastrukturore dhe financiare.

Prania e diversitetit gjeografik dhe demografik mes njësisive administrative kërkon një qasje të diferencuar në planifikimin dhe ofrimin e arsimit parashkollor, për të garantuar akses të barabartë dhe cilësi të njëtrajtshme të shërbimit në të gjithë territorin e Bashkisë.


Aktualisht, Bashkia Kolonjë përfshin gjithsej 8 njësi administrative:

- ✚ Ersekë
- ✚ Qendër Ersekë
- ✚ Qendër Leskovik
- ✚ Novoselë
- ✚ Barmash
- ✚ Mollas
- ✚ Çlirim
- ✚ Leskovik

të cilat përbëjnë bazën e ofrimin të shërbimeve publike, përfshirë arsimin parauniversitar, kopshtet dhe shkollat publike.

Të dhëna demografike

Sipas të dhënave më të fundit demografike, numri total i banorëve në Bashkinë Kolonjë është 7,519 banorë, me një shpërndarje të përafërt gjinore prej 3,809 meshkuj dhe 3,710 femra. Struktura e popullsisë karakterizohet nga një përqindje e konsiderueshme e fëmijëve në moshë parashkollore dhe të rinjve, gjë që nënvizon rëndësinë e zhvillimit dhe forcimit të shërbimeve arsimore në këto kategori.




Emri i Njesise Administrative	Numri i banoreve sipas gjinisë	Vlera
Ersekë	Femer	1428
	Mashkull	1394
Qendër Ersekë	Femer	932
	Mashkull	1009
Qendër Leskovik	Femer	76
	Mashkull	97
Novoselë	Femer	87
	Mashkull	111
Barmash	Femer	117
	Mashkull	129
Mollas	Femer	548
	Mashkull	548
Çlirim	Femer	48
	Mashkull	56
Leskovik	Femer	474
	Mashkull	465

Përshkrim Demografik sipas njësive administrative në Bashkinë Kolonjë:

- ✦ Erseka paraqitet si njësi më e populluar, me gjithsej **2,822 banorë**, prej të cilëve **1,428 janë femra** dhe **1,394 meshkuj**. Balanca gjinore është pothuajse e barabartë.
- ✦ Qendër Ersekë ka gjithsej **1,941 banorë**, me **932 femra** dhe **1,009 meshkuj**. Vërehet një numër disi më i lartë meshkujsh krahasuar me femrat.
- ✦ Qendër Leskovik është një ndër njësitë më pak të populluara, me **173 banorë**, ku **76 janë femra** dhe **97 meshkuj**.
- ✦ Novoselë ka një popullsi prej **198 banorësh**, me **87 femra** dhe **111 meshkuj**. Edhe këtu vihet re një diferencë në favor të meshkujve.
- ✦ Barmash numëron gjithsej **246 banorë**, me **117 femra** dhe **129 meshkuj**, duke ruajtur një balancë të ngjashme me njësitë e tjera rurale.
- ✦ Mollas ka një shpërndarje të barabartë gjinore, me **548 femra** dhe **548 meshkuj**, për një total prej **1,096 banorësh**.
- ✦ Çlirim është një nga njësitë më të vogla me vetëm **104 banorë**, prej të cilëve **48 janë femra** dhe **56 meshkuj**.
- ✦ Leskovik ka gjithsej **939 banorë**, me një ndarje të afërt gjinore: **474 femra** dhe **465 meshkuj**.

Grupmosha	Numri i banoreve
0-4 vjeç	189
05-9 vjeç	257
10-14 vjeç	341
15-19 vjeç	348



Kuadri ligjor dhe politika që përcakton bazën referuese për detyrat dhe përgjegjësitë në fushën e arsimit në nivel vendor

Në Bashkinë e Kolonjës, detyrat dhe përgjegjësitë në fushën e arsimit parauniversitar mbështeten në kuadrin ligjor dhe politik kombëtar që rregullon funksionimin e sistemit arsimor në Republikën e Shqipërisë. **Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar”**, i ndryshuar, përcakton strukturën dhe përmbajtjen e arsimit në të gjitha nivelet – përfshirë arsimin parashkollor, bazë, të mesëm të përgjithshëm dhe profesional – si dhe detyrimet e institucioneve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor për garantimin e cilësisë dhe gjithëpërfshirjes në arsim.

Përveç tij, **Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”** i ka ngarkuar njësitë të qeverisjes vendore, përfshirë Bashkinë e Kolonjës, kompetenca të drejtpërdrejta në ofrimin e shërbimeve të arsimit parashkollor. Bashkia është përgjegjëse për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e çerdheve dhe kopshteve publike në territorin e saj, përfshirë sigurimin e infrastrukturës, furnizimeve dhe stafit ndihmës. Për arsimin bazë dhe të mesëm, edhe pse kompetencat kryesore i përkasin Ministrisë së Arsimit dhe strukturave të saj vendore, Bashkia ka një rol të rëndësishëm mbështetës, veçanërisht në menaxhimin e infrastrukturës, mbështetjen e transportit të nxënësve, aksesit për fëmijët me nevoja të veçanta dhe sigurisë në institucionet arsimore.

Në zbatim të këtyre detyrimeve, Bashkia Kolonjë harton dhe zbaton politika vendore për arsimin, të cilat janë të orientuara nga prioritetet kombëtare dhe nevojat lokale. Këto politika janë të integruara në dokumente strategjike si **Plani i Përgjithshëm Vendor, Plani Social 2024-2026**, si dhe dokumente specifike për sektorin e arsimit, ku pasqyrohen nevojat infrastrukturore, numri dhe shpërndarja e fëmijëve në territor, burimet njerëzore, përfshirja e grupeve vulnerabël dhe bashkëpunimi me komunitetin e prindërve dhe partnerë të tjerë.


Gjithashtu, Bashkia e Kolonjës bashkëpunon ngushtësisht me **Zyrën Vendore Arsimore (ZVA)** dhe institucionet arsimore publike për të garantuar koordinimin institucional në zbatimin e politikave dhe standardeve arsimore, përmirësimin e kushteve të mësimdhënies dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve për nxënësit. Ky bashkëpunim mundëson ndërhyrje të përbashkëta në rastet që lidhen me rikonstruksionin e objekteve shkollore, menaxhimin e emergjencave, regjistrimet në institucione arsimore dhe përfshirjen e fëmijëve që rrezikojnë të mbeten jashtë sistemit arsimor.

Në këtë mënyrë, Bashkia e Kolonjës vepron si një aktor kyç në zbatimin e politikave arsimore në territorin e saj, duke kontribuar në sigurimin e një arsimi cilësor, gjithëpërfshirës dhe të qasshëm për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë në territor

2. Analiza e shërbimit të arsimit parashkollor në vitin shkollor 2024 – 2025

Mbulimi i ofrimit të shërbimit të arsimit parashkollor 0000

Në Bashkinë Kolonjë shpërndarja e institucioneve arsimore sipas njësive administrative tregon një prani të konsiderueshme të infrastrukturës shkollore dhe të arsimit parashkollor në të gjithë territorin. Bazuar në të dhënat e paraqitura, në Bashkinë Kolonjë funksionojnë 13 kopshte të shpërndara në zonat urbane dhe rurale të territorit të saj. Shpërndarja gjeografike e kopshtit tregon një përpjekje për të garantuar akses të barabartë në edukimin parashkollor, si në qendrat urbane ashtu edhe në zonat më të thella rurale.



Njesia Administrative	Numri i Kopshteve
Ersekë	2
Qendër Ersekë	6
Qendër Leskovik	0
Novoselë	1
Barmash	0
Mollas	3
Çlirim	0
Leskovik	1


Frekuentimi në kopshte

Në bashkinë Kolonjë, sipas të dhënave më të fundit, numri total i fëmijëve të moshës 3-6 vjeç është 151, prej të cilët 75 janë djem dhe 76 janë vajza. Nga kjo popullsi, 107 fëmijë ndjekin institucionet parashkollore (kopshtin), konkretisht 54 djem dhe 53 vajza.

Kjo përfaqëson një përqindje të përgjithshme prej 70.86% të fëmijëve që janë të përfshirë në arsimimin parashkollor. Megjithatë, 44 fëmijë ende nuk ndjekin kopshtin nga të cilët 21 janë djem dhe 23 janë vajza, duke treguar një boshllëk të rëndësishëm në përfshirje që kërkon vëmendje institucionale.

Të dhënat mbi përfshirjen e fëmijëve të moshës 3-6 vjeç në arsimin parashkollor tregojnë se në total 70.86% e fëmijëve ndjekin kopshtin. Brenda këtij grupi, përqindja e përfshirjes ndryshon midis gjinive: 72% e djemve dhe 69.74% e vajzave janë të përfshirë në edukimin parashkollor. Ky ndryshim, tregon prirje që mund të ndikohen nga faktorë lokalë si infrastruktura, ndërgjegjësimi prindëror apo mundësitë ekonomike.

Grafiku më poshtë paraqet përqindjen e fëmijëve të moshës 3-6 vjeç që ndjekin dhe nuk ndjekin kopshtin sipas gjinisë:



Bazuar në të dhënat mbi përfshirjen e fëmijëve të moshës 3-6 vjeç në arsimin parashkollor në Bashkinë Kolonjë, rekomandohet që Bashkia Kolonjë të intensifikojnë përpjekjet për të garantuar akses të barabartë dhe gjithëpërfshirës në kopsht. Duhet të ndërmerren masa për të identifikuar dhe adresuar pengesat që ndikojnë në përjashtimin e një pjese të fëmijëve, përfshirë:

- ✚ përmirësimin e infrastrukturës në zonat më të largëta,
- ✚ ofrimin e mbështetjes financiare për familjet në nevojë dhe
- ✚ rritjen e ndërgjegjësimit të prindërve për rëndësinë e edukimit të hershëm.

Po ashtu, është e rëndësishme të monitorohen dhe analizohen më tej diferencat gjinore në përfshirje, në mënyrë që të sigurohet trajtim i barabartë për vajzat dhe djemtë që në fazat e para të edukimit.

3. Analiza e shërbimit të në shkolla bazë dhe atij të mesëm në vitin shkollor 2024 – 2025


Mbulimi i ofrimit të shërbimit të arsimit

Në territorin e **Bashkisë** Kolonjë janë të shpërndara gjithsej 18 **institucione arsimore** të niveleve të ndryshme, të cilat mbulojnë të gjitha njësitet administrative urbane dhe rurale të bashkisë. Këto institucione përfaqësojnë një **rrjet të gjerë dhe të larmishëm të arsimit parauniversitar**.

Shkollat në territorin e Bashkisë janë të organizuara dhe të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë sa më mirë nevojat arsimore të komunitetit. Ato klasifikohen në disa nivele sipas ciklit të edukimit që ofrojnë, duke përfshirë: shkolla fillore (8 gjithsej), shkolla 9-vjeçare (7 gjithsej) dhe shkolla të mesme (3 gjithsej).

- ✚ **Shkollat fillore** gjithsej 8 u shërbejnë fëmijëve në fazat e para të edukimit, duke u ofruar njohuritë bazë në lexim, shkrim, matematikë dhe lëndë të tjera themelore. Ato janë të përhapura në mënyrë të tillë që të jenë sa më pranë vendbanimeve për të siguruar akses të lehtë për nxënësit e vegjël.
- ✚ **Shkollat 9-vjeçare**, gjithsej 7 në numër, përfshijnë si ciklin fillor, ashtu edhe atë të mesëm të ulët, dhe janë projektuar për të ofruar një arsim të plotë bazë. Ato luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin akademik dhe shoqëror të nxënësve dhe përgatitjen e tyre për nivelin e ardhshëm arsimor.
- ✚ **Shkollat e mesme**, në numër prej 3, që përfshijnë gjimnazet dhe shkollat profesionale, janë institucione që synojnë të formojnë të rinjtë për studime të mëtejshme universitare apo për përgatitje për tregun e punës. Këto shkolla janë të vendosura në zona strategjike për të përfshirë një numër sa më të madh nxënësish nga zona të ndryshme të bashkisë.

Në tërësi, rrjeti arsimor i Bashkisë është konceptuar për të siguruar mundësi të barabarta arsimimi për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë, pavarësisht vendbanimit apo kushteve ekonomike.



Frekuentimi në arsimin fillor

Në arsimin fillor janë të regjistruar gjithsej 269, nga të cilët 140 janë djem dhe 129 vajza. Sipas të dhënave të raportuara, 52.04% e tyre janë djem dhe 47.96% vajza. Kjo ndarje reflekton situatën e përfshirjes në këtë nivel arsimor, e cila ndryshon nga njësi në njësi, në varësi të kushteve lokale, demografisë, dhe mundësive të ofruara në komunitet.

Gjinia	Numri i Nxënësve	Përqindja (%)
Djem	140	52.04
Vajza	129	47.96


Për të garantuar përfshirje të barabartë në arsimin fillor, rekomandohet që institucionet arsimore dhe Bashkia Kuçovë të vijojnë përpjekjet për të reduktuar çdo pabarazi që mund të vijë nga faktorë

lokalë si distanca nga shkolla, infrastruktura e papërshtatshme, apo mungesa e mbështetjes familjare. Investimet në transport shkollor, përmirësimi i kushteve mjedisore të shkollave dhe fushatat ndërgjegjësuere për rëndësinë e edukimit fillor janë thelbësore për të rritur përfshirjen dhe për të siguruar arsim të aksesueshëm dhe cilësor për çdo fëmijë, pavarësisht gjinisë apo vendbanimit.

000000000000000000

Frekuentimi arsimi 9-vjeçar

Në arsimin 9-vjeçar janë të regjistruar gjithsej 281 nxënës, prej të cilëve 158 janë djem dhe 123 vajza. Sipas të dhënave, 56.23% e nxënësve janë djem dhe 43.77% janë vajza. Kjo shpërndarje pasqyron situatën aktuale të përfshirjes në këtë nivel arsimor, e cila ndryshon nga njësi në njësi dhe ndikohet nga faktorë të ndryshëm lokalë.




Rekomandohet një analizë më e thelluar e faktorëve që ndikojnë në pjesëmarrjen më të ulët të vajzave në arsimin 9-vjeçar, veçanërisht në zonat rurale apo më të thella. Mund të jetë e nevojshme të ndërmerren masa konkrete për të mbështetur vazhdimësinë arsimore të vajzave, përmes përmirësimit të kushteve të shkollave, ndihmës për transportin, fushatave për ndërgjegjësim të komunitetit, si dhe përfshirjes së familjeve në mbështetje të edukimit të vajzave. Këto ndërhyrje janë të rëndësishme për të siguruar akses dhe përfshirje të barabartë në arsimin bazë për të gjithë fëmijët

Pavarësisht variacioneve, këto të dhëna nënvizojnë rëndësinë e monitorimit të rregullt të pjesëmarrjes së fëmijëve në arsim dhe nevojën për politika që mbështesin vazhdimësinë e shkollimit për të gjithë. Sigurimi i kushteve të favorshme për ndjekjen e arsimit 9-vjeçar është thelbësor për garantimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe të barabartë për çdo fëmijë.

Frekuentimi arsimi i mesëm

Në arsimin e mesëm janë të regjistruar gjithsej 233 nxënës, nga të cilët 116 janë djem dhe 117 vajza, përkatësisht 49.79% djem dhe 50.21% vajza. Ndarja gjinore në këtë nivel arsimor pasqyron situatën e raportuar për njësinë përkatëse, por këto përqindje mund të jenë të ndryshme në zona të tjera. Shpërndarja e pjesëmarrjes në arsimin e mesëm ndikohet nga faktorë të shumtë si zgjedhjet individuale, mundësitë për të ndjekur shkolla të përgjithshme apo profesionale, si dhe faktorë socialë, ekonomikë apo kulturorë. Kjo e bën të nevojshme që të mbështetet përfshirja e vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse në këtë nivel të rëndësishëm të arsimit.

Ky ekuilibër pozitiv duhet të ruhet dhe të përforcohet përmes politikave të qëndrueshme që mbështesin arsimimin e të rinjve pavarësisht gjinisë. Rekomandohet vijimi i masave që sigurojnë kushte të përshtatshme mësimore, mbështetje psikosociale dhe orientim në karrierë për të gjithë nxënësit,



si dhe përfshirje më e madhe e familjes dhe komunitetit në procesin edukativ. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet mbajtjes së vajzave në shkollë në zona rurale, për të garantuar vazhdimësinë e këtij progresi gjinor edhe në të ardhmen.

4. Shërbimi i Arsimit sipas njësive administrative

Njësia Administrative: Ersekë

Kopshtet

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit për fëmijët e moshës parashkollore, në këtë njësi administrative funksionon një rrjet kopshtesh që synon të ofrojë edukim cilësor dhe mbështetje gjithëpërfshirëse për zhvillimin e fëmijëve të moshës 3–6 vjeç. Aktualisht, në territorin e njësisë janë të hapura **2 kopshte**, të shpërndara në zona të ndryshme me qëllim të garantimit të aksesit të barabartë për të gjitha familjet e komunitetit. Këto institucione luajnë një rol kyç si në përgatitjen e hershme për shkollë, ashtu edhe në ofrimin e mbështetjes sociale për familjet.

Lista e kopshteve përfshin:

Emri i kopshtit
“Afërdita Kole“
“Marie Gjergo”

Shkollat

Në këtë njësi funksionojnë gjithsej **2 shkolla**, të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal. Ndër to, **1 është shkollë 9-vjeçare**, e cila ofron ciklin bazë të arsimit, dhe **1 është shkollë e mesme**, që u jep të rinjve mundësinë të vazhdojnë arsimin e lartë ose të përgatiten për tregun e punës me aftësi profesionale.

Përmes këtij sistemi, njësia siguron një shtrirje të gjerë të shërbimeve arsimore, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit dhe krijimin e kushteve për rritje të nivelit të arsimit dhe mirëqenies sociale.

Këto institucione janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mundësojnë akses të qëndrueshëm në arsim për fëmijët e zonës, si në vendbanimet qendrore ashtu edhe në ato periferike apo rurale.

Emri i Shkollës	Tipi i Shkollës
“Petro Nini Luarasi”	Shkollë e mesme e përgjithshme
“Papa Kristo Negovani”	9-vjeçare

Konvikti për nxënësit në Ersekë

Konvikti që funksionon në qytetin e Ersekës aktualisht strehon **6 fëmijë**, të cilët ndjekin arsimin në shkollat e zonës. Megjithatë ofron një zgjidhje për ata që vijnë nga zona të largëta dhe nuk kanë mundësi udhëtimi të përditshëm, kushtet e konviktit lënë për të dëshiruar. Ambientet janë të amortizuara, me mungesë të pajisjeve bazë për jetesë dhe mësim, higjiena nuk është në nivelin e duhur. Kjo situatë kërkon ndërhyrje të menjëhershme për përmirësim të infrastrukturës, rritje të cilësisë së shërbimeve dhe garantimin e një ambienti të sigurt, të ngrohtë dhe të përshtatshëm për zhvillimin e fëmijëve që qëndrojnë aty.

Njësia Administrative: Qendër Ersekë

Kopshtet

Aktualisht, në territorin e njësisë Qendër Ersekë janë të hapura gjithsej 4 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit. Lista e kopshteve përfshin:

Emri i kopshtit
Fluturat
Rreze Dielli
Dallëndyshet 1
Dallëndyshet 2

Shkollat

Në Njësinë Administrative **Qendër Ersekë** funksionojnë gjithsej **6 shkolla**, të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal. Nga këto, **4 janë shkolla fillore**, që ofrojnë mësim për ciklin e ulët të arsimit bazë, ndërsa **2 janë shkolla 9-vjeçare**, të cilat përfshijnë si ciklin fillor ashtu edhe atë të mesëm të arsimit bazë.

Lista e shkollave përfshin:

Emri i Shkollës	Tipi i Shkollës
"Mehmet Pepi Starje"	9-vjeçare
"Jonuz Gora" Selenicë	9-vjeçare
"Ropi Stillo" Gostivisht	Fillore
Taç Poshtë	Fillore
Kagjinat	Fillore
"Shaniko Jaupasi" Kaskollarë	Fillore

Njësia Administrative: Barmash

Kopshtet

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative funksionon 1 kopsht

Lista e kopshteve përfshin:

Emri i kopshtit
3 Fluturat

Shkollat

Në Njësinë administrative Barmash funksionojnë 3 shkolla. Nga këto, 1 shkollë është e ciklit fillor, ndërsa 2 prej tyre janë shkolla 9-vjeçare që ofrojnë ciklin bazë të arsimit,

Emri i Shkollës	Tipi i Shkollës
“Shefki Elmazi” Mesicë	9-vjeçare
Shkolla Shalës	Fillore
“Tefik Azizi” Barmash	9-vjeçare

Njësia Administrative: Mollas

Kopshtet

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative funksionojnë gjithsej 3 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit.

Lista e kopshteve përfshin:

Emri i kopshtit
“Bambi”
“Tre fluturat”
“Dallendyshe”

Shkollat

Në Njësinë administrative Mollas funksionojnë 6 shkolla, të cilat janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal. Nga këto, 3 shkolla janë në ciklin fillor, ndërsa 2 prej tyre janë shkolla 9-vjeçare që ofrojnë ciklin bazë të arsimit, dhe 1 janë shkollë e mesme.



Lista e shkollave përfshin:

Emri i Shkollës	Tipi i Shkollës
Mihallaq Thoma	9-vjeçare
Mina Demiri	9-vjeçare
Hasan Qinami	Fillore
Tre Dëshmorët Boshanj	Fillore

Mustafa Jashari Mollas	E mesme e bashkuar
Nasi Vodica Vodic毛	Fillore

Njësia Administrative: Leskovik

Kopshtet

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative funksionojnë gjithsej 3 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit.

Lista e kopshteve përfshin:


Emri i kopshtit
"Borebardha"
"Flutura"
"Hirushja"

Shkollat

Në total, funksionon 1 shkollë e mesme e bashkuar:

Emri i Shkolles	Tipi i shkollës
"Jani Vreto"	E mesme e bashkuar

5. Vizioni, Qëllimet Strategjike, Objektivat dhe përmbledhja e ndërhyrjeve për përmirësimin e Arsimit Parauniversitar



Vizioni

“Të sigurojmë për çdo fëmijë në territorin e Bashkisë Kolonjë akses në arsim parauniversitar gjithëpërfshirës, cilësor dhe të drejtë, të zhvilluar në mjedise të sigurt dhe të përshtatshme, me mësues të përgatitur dhe mbështetje të vazhdueshme, duke e trajtuar arsimin si një shtyllë themelore për zhvillimin social dhe ekonomik të komunitetit, forcimin e barazisë dhe pjesëmarrjen aktive në jetën shoqërore dhe institucionale.”

Përmbledhje e Qëllimeve, Objektivave dhe Aktiviteteve

Duke u mbështetur në rrjetin ekzistues të institucioneve arsimore, nga kopshtet deri në shkollat e mesme dhe duke adresuar sfidat aktuale të aksesit, infrastrukturës dhe përfshirjes gjinore, Bashkia Kolonjë ka për synim:

- **Përmirësimin e infrastrukturës arsimore**, veçanërisht në zonat rurale, për të garantuar kushte dinjitoze mësimi në çdo shkollë e kopsht;
- **Përmirësimin e përfshirjes në arsimin parashkollor**, duke mbështetur prindërit dhe rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e edukimit të hershëm;
- **Zvogëlimin e pabarazive gjinore dhe sociale** në ndjekjen e shkollës në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar;
- **Rritjen e cilësisë së mësimdhënies**, përmes investimit në zhvillimin profesional të mësuesve dhe përdorimin e metodologjive bashkëkohore;
- **Forcimin e partneriteteve me komunitetin dhe institucionet arsimore** për të mbështetur suksesin e çdo nxënësi.

Qëllimi 1 (Q1) Sigurimi i një mjedisi arsimor të sigurt, funksional dhe gjithëpërfshirës

Të garantohen kushte të qëndrueshme infrastrukturore dhe funksionale për të gjitha institucionet arsimore në territorin e Bashkisë Kolonjë, përmes mirëmbajtjes sistematike dhe investimeve të orientuara drejt standardeve bashkëkohore.

- **Objektivi 1.1** – Të sigurohet ofrimi i shërbimeve mbështetëse në mënyrë të vazhdueshme dhe efektive, duke përfshirë pagesat e personelit mësues në arsimin parashkollor dhe

personelit ndihmës në kopshte dhe shkolla, mirëmbajtjen e ambienteve shkollore, përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare, funksionimin e sistemeve të ngrohjes, furnizimin me kancelari, mjete didaktike, ushqim, dokumentacion dhe transport.

- **Objektivi 1.2** – Të investohet në përmirësimin e infrastrukturës arsimore, përmes ndërtimit ose rikonstruksionit të kopshteve dhe institucioneve arsimore, pajisjes me mobilie si dhe ngritjes së një sistemi elektronik për regjistrimin dhe menaxhimin e të dhënave të institucioneve arsimore.

Qëllimi 2 (Q2) Mbështetje për zhvillimin e plotë të fëmijëve përmes edukimit cilësor dhe përkujdesjes së integruar

Të sigurohet zhvillimi emocional, social dhe kognitiv i çdo fëmije përmes shërbimeve edukative gjithëpërfshirëse dhe mbështetjes psiko-sociale në mjedise të sigurta dhe përkujdesëse.

- **Objektivi 2.1** – Të përmirësohet cilësia e edukimit në institucionet parashkollore përmes mbështetjes së kopshteve me mjete dhe organizimit të trajnimeve për edukatorët dhe ngritjes së kapaciteteve të stafit për të ofruar një edukim të hershëm gjithëpërfshirës dhe bashkëkohor.
- **Objektivi 2.2** – Të forcohet përkujdesja sociale për fëmijët përmes angazhimit të mësuesve ndihmës, ofrimit të shërbimeve psiko-sociale, krijimit dhe fuqizimit të strukturave menaxhuese pjesëmarrëse (këshillat e prindërve dhe bordet e shkollës), si dhe mbështetjes së nxënësve nga familjet në nevojë apo me rezultate të larta.

Qëllimi 3 (Q3) Zhvillimi i talenteve dhe ndjesisë së përkatësisë përmes veprimtarive jashtëmësimore

Të promovohet zhvillimi i potencialit krijues, fizik dhe social të fëmijëve përmes një kalendari të pasur aktiviteteve jashtëmësimore që nxisin shëndetin, bashkëpunimin dhe përfshirjen komunitare.

- **Objektivi 3.1** – Të organizohen rregullisht veprimtari kulturore, sportive dhe ndërgjegjësuëse, si: ngjarje artistike, ekspozita, ditë ndërkombëtare tematike, aktivitete mjedisore dhe lokale, për të nxitur zhvillimin e aftësive dhe pjesëmarrjen aktive të fëmijëve në jetën shoqërore.

Përmbledhje e investimeve kapitale (2025–2028)

Plani i investimeve kapitale për përmirësimin e arsimit parauniversitar në Bashkinë Kolonjë për periudhën 2025–2028 parashikon një kërkesë financiare totale prej **36,602 mijë lekësh**. Kryesisht, ndërhyrjet do të fokusohen në:

- **Rikonstruksionin e ambjenteve dhe terreneve sportive**, me synim krijimin e hapësirave të sigurta dhe funksionale për aktivitet fizik dhe socializim të nxënësve;
- **Hapjen e një kopshti me shërbim ushqimi (drekë)** për të zgjeruar aksesin dhe përkujdesjen ndaj fëmijëve të moshës parashkollore;
- **Rikonstruksionin e konviktit të nxënësve në Ersekë**, për të siguruar kushte jetese dinjitoze për fëmijët që ndjekin shkollën larg vendbanimit.

Këto ndërhyrje përfaqësojnë një hap të rëndësishëm drejt arritjes së standardeve bashkëkohore në institucionet arsimore të Bashkisë Kolonjë, duke pasur në fokus barazinë në akses, mirëqenien e fëmijëve dhe zhvillimin e potencialit të tyre në një mjedis të sigurt, gjithëpërfshirës dhe mbështetës.

Investimet synojnë të forcojnë lidhjen ndërmjet shkollës dhe komunitetit, duke e konsideruar arsimin si themelin e zhvillimit social dhe ekonomik të zonës.



6. Planifikimi afatmesëm buxhetor i shërbimit të Arsimit parauniversitar

Të ardhurat vendore dhe transferimet nga qeveria qendrore për shërbimin e arsimit parauniversitar

Të dhënat financiare për shërbimin e arsimit parauniversitar

Ky seksion përmbledh informacionin financiar që lidhet me funksionimin dhe zhvillimin e sistemit të arsimit parauniversitar në nivel bashkie.

Bashkia siguron financim për arsimin bazuar në të ardhurat përmes transfertave specifike dhe të përgjithshme të siguruara nga qeveria qendrore si dhe nga taksat dhe tarifat vendore. Transferimet specifike mbulojnë zërat e mëposhtëm:

- Arsimi parashkollor: përfshirë pagat e stafit arsimor dhe ndihmës, kostot e mirëmbajtjes dhe funksionimin e infrastrukturës së kopshteve, si dhe mbështetjen për përfshirje të fëmijëve nga grupe vulnerabel.
- Arsimi 9-vjeçar Arsimi i mesëm: përfshirë pagat për punonjësit ndihmës, mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së shkollave;
- Arsimi profesional përfshin ofrimin e shërbimit për nxënësit e arsimit profesional që frekuentojnë dhe konviktet;
- Funksionimin e Qendrës kulturore të fëmijëve ose njësi të tjera mbështetëse të edukimit jashtëshkollor, duke përfshirë paratë e personelit mësues dhe ndihmës, mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës.

Të dhënat financiare janë të raportuara në mijë lekë dhe pasqyrojnë kontributin për secilën kategori për vitin aktual, si dhe për vitet e mëparshme për të mundësuar analizë krahasimore.

Ky informacion është i domosdoshëm për të kuptuar financimin buxhetor të shërbimit të arsimit parauniversitar, mënyrën e plaifikuar të përdorimit të fondeve publike për arsimin parauniversitar, si dhe për të identifikuar boshllëqet ose mundësitë për investime të reja në funksion të përmirësimit të cilësisë së edukimit

Për periudhën 2026–2028, buxheti total i planifikuar për arsimin parashkollor është 246,591 mijë lekë, të 0detajuaja sipas aktiviteteve më poshtë:

Kodi i Llogarisë	Aktivitetet	Viti 2025 në mijë lekë	Viti 2026 në mijë lekë	Viti 2027 në mijë lekë	Viti 2028 në mijë lekë	Shuma në mijë lekë
600+601	Shpenzime personeli	52330	51030	51030	51030	205420
602	Shpenzime korrente	7478	7477	9477	9477	33909
231	Investime	7262	0	0	0	7262
	Shuma	67070	58507	60507	60507	246591

Për periudhën 2025–2028, buxheti total i planifikuar për arsimin parauniversitar (shkollat) është 89,508 mijë lekë, të detajuaja sipas aktiviteteve më poshtë:

Kodi i Llogarisë	Aktivitetet	Viti 2025 në mijë lekë	Viti 2026 në mijë lekë	Viti 2027 në mijë lekë	Viti 2028 në mijë lekë	Shuma në mijë lekë
600+601	Shpenzime personeli	12315	11552	11552	11552	46971
602	Shpenzime korrente	3024	3240	3576	3357	13197
231	Investime	22575	2184	2181	2400	29340
	Shuma	37914	16976	17309	17309	89508

7. Plani i Veprimit (matrica e aktiviteteteve)

Qëllimi 1 (Q1) – Sigurimi i një mjedisi arsimor të sigurt, funksional dhe gjithëpërfshirës					
Objektivi specifik O1. Të sigurohet ofrimi i shërbimeve mbështetëse në mënyrë të vazhdueshme dhe efektive, duke përfshirë pagesat e personelit mësues në arsimin parashkollor dhe personelit ndihmës në kopshte dhe shkolla, mirëmbajtjen e ambienteve shkollore, përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare, funksionimin e sistemeve të ngrohjes, furnizimin me kancelari, mjete didaktike, ushqim, dokumentacion dhe transport.					
Aktivitete	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
Mbështetja me pagesën dhe sigurimin punonjësve e arsimit (parashkollor, bazë dhe atij të mesëm)	2025–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin,	Këshilli Bashkiak	Transfertë specifike + Buxhet vendor	Nr. i punonjësve të mbështetur financiarisht; Nr. i fëmijëve të regjistruar në kopsht (vajza/djem; nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel) që përfitojnë shërbimi i arsimit parashkollor
Mirëmbajtja dhe përmirësimi i vazhdueshëm i infrastruktures arsimore	2025–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet;	Shkollat, kopshtet	Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar	Nr. ndërhyrjeve të realizuara në godina (Lyerje, ndarje ambienteve, mirëmbajtje kaldajash, elektroshtepiakësh, kompjuterash, printerash, pajisjesh të zyrave)
Garantimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve higjieno-sanitare	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike	Shkollat, operatorë të higjienës, kopshtet	Buxhet vendor, transfertë e pakushtëzuar	Nr. i shkollave me kushte të përmirësuara higjieno-sanitare
Sigurimi i sistemit të ngrohjes funksional për të gjitha institucionet arsimore	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike	Operatorë të energjisë,	Buxhet vendor + transfertë specifike	Nr. i institucioneve me sistem funksional ngrohjeje

Furnizimi me kancelari për institucionet arsimore	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin,	Shkollat	Buxhet vendor	Nr. i institucioneve të furnizuara me kancelari
Furnizimi, kontrolli dhe kolaudimi i fiksve të zjarrit	2026–2028	Zyra e Emergjencave	Zjarrfikësja, NjA	Buxhet vendor	Nr. i fiksve të vendosura dhe funksionale
Furnizimi me dokumentacion administrativ për institucionet arsimore	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin,	Shkollat	Buxhet vendor	Nr. i shkollave të pajisura me dokumentacion
Furnizimi me mjete didaktike për institucionet arsimore	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin,	Kopshtet MAS	Buxhet vendor + donacione, prindërit	Nr. i institucioneve të pajisura me mjete didaktike
Furnizimi dhe shërbimi ushqimor në institucionet e arsimit parashkollor	2026–2028	Zyra Shëndetit Publik & Arsimit	Operatorët e licencuar, Ministria e Arsimit, Sportit (MAS)	Buxhet vendor	Nr. i mensave funksionale në kopshte
Kryerja e shërbimit të dezinfektimit në institucionet arsimore	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike	Instituti i Shëndetit Publik (ISHP), operatorë të kontraktuar	Buxhet vendor + fond emergjence	Nr. i dezinfektimeve të kryera në vit
Ofrimi dhe sigurimi i shërbimit të transportit për mirëadministrimin dhe shërbimet për institucionet arsimore	Çdo vit	ZVA	Drejtoria e Transporteve, administrata	Buxheti i Bashkisë	Shpenzime për karburant, siguracione, pjesë këmbimi për 3 automjete të shërbimit të DA, dhe udhëtime për administratën

Objekti i specifik O1.2 Të investohet në përmirësimin e infrastrukturës arsimore, përmes ndërtimit ose rikonstruksionit të kopshteve dhe institucioneve arsimore, pajisjes me mobilie si dhe ngritjes së një sistemi elektronik për regjistrimin dhe menaxhimin e të dhënave të institucioneve arsimore.

Aktivitet	Periudha e Përgjegjëse	Partnerë	Burimet	Tregues
-----------	------------------------	----------	---------	---------

Investime në infrastrukturën e institucioneve të arsimit parashkollor	zbatimit	Njësia përgjegjëse	Qeveria	financiare	Nr. i institucioneve arsimore të rikonstruktura, përmirësim i kushteve
Hapja e kopshtit me drekë "Marie Gjergo"	2025	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet	Qeveria shqiptare Bashkia, donatorë	Buxheti i Bashkisë, transferime nga qeveria qendrore	Nr. i institucioneve arsimore të rikonstruktura, përmirësim i kushteve
Investime në infrastrukturën e institucioneve të arsimit bazë dhe atij të mesëm - Rikonstruksion i Ambjenteve Sportive - Rikonstruksion i terreneve sportive të shkollës "Jani Vreto", Leskovik - Rikonstruksion i konviktit	Çdo vit 2025–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet	Drejtoria e Arsimit	Buxheti i Bashkisë	Nr. i infrastrukturës shkollore e rikonstruktuar dhe e mirëmbajtur
Ndërtim i një sistemi të dhënash digjitale për kopshtet dhe shkollat në kuadër të planit për përmirësim të arsimit parauniversitar	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet	Kopshtet/shkollat; Ekspertë të jashtëm për mbështetje	Buxheti i Bashkisë (orë pune punonjës të angazhuar në punë), 0	Një regjistër i shërbimit për arsimin parashkollor, arsimin bazë dhe atë të mesëm I krijuar, dhe I përditësuar çdo vit me të dhëna

Qëllimi 2 (Q2) – Mbështetje për zhvillimin e plotë të fëmijëve përmes edukimit cilësor dhe përkujdesjes së integruar

Objekti i specifik O2.1 Të përmirësohet cilësia e edukimit në institucionet parashkollore përmes mbështetjes së kopshteve me mjete dhe organizimit të trajnimeve për edukatorët dhe ngritjes së kapaciteteve të stafit për të ofruar një edukim të hershëm gjithëpërfshirës dhe bashkëkohor.

Aktivitete	Perioda e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
------------	--------------------	------------	----------	--------------------	---------

Pajisje me materiale didaktike, kompjuterë dhe trajnime për edukatorët	Çdo vit	Njësia përgjegjëse për arsimin,	MAS, partnerë zhvillimi	Buxhet vendor, partnerë	Nr. i fëmijëve (vajza/djem; nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel) që përfitojnë nga mjetet dhe trajnimet
Fuqizimi i kapaciteteve të stafit arsimor të institucioneve parashkollore, në funksion të garantimit të një edukimi cilësor dhe mbështetës për zhvillimin e hershëm të fëmijëve.	2025–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin,	MASR, institucionet arsimore, OSHC, ASKAP	Buxhet vendor, projekte me financim të huaj	Nr. i edukatorëve të trajnuara; përmirësimi i praktikave të mësimdhënies;

Objektivi specifik O2.2 Të forcohet përkujdesja sociale për fëmijët përmes angazhimit të mësuesve ndihmës, ofrimit të shërbimeve psiko-sociale, krijimit dhe fuqizimit të strukturave menaxhuese pjesëmarrëse (këshillat e prindërve dhe bordet e shkollës), si dhe mbështetjes së nxënësve nga familjet në nevojë apo me rezultate të larta.

Aktivitet	Periodha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
Angazhimi i mësuesve ndihmës në kopshte	2025–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për burimet njerëzore	OJQ sociale, MAS	Transferime specifike - Fondi i pagave (buxheti vendor)	Nr. i fëmijëve (vajza/djem; nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel) me ndihmë sociale;
Institucionalizimi dhe funksionalizimi i strukturave menaxhuese pjesëmarrëse dhe këshilluese në institucionet arsimore, përfshirë Bordin e institucionit, Këshillin e Prindërve dhe Komisionin e Shëndetit, Sigurisë dhe Mjedisit në kopshtet dhe shkollat.	2025–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin	Administratorët e Njësive Administrative; këshilli bashkiak; Kopshtet; Prindërit	Transferime specifike - Fondi i pagave (buxheti vendor)	Struktura menaxhuese në kopshte dhe shkolla aktive Pjesëmarrja e balancuar gjinore e prindërve (nënë/baba) në strukturat menaxhuese të kopshteve dhe shkollave
Ofrimi i shërbimit psiko-social në kopshte	2025–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për burimet njerëzore; Njësia përgjegjëse për shërbimet	Kopshtet; OSHC	Transferime specifike - Fondi i pagave (buxheti vendor)	Nr. i fëmijëve (vajza/djem; nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel) të mbështetur me shërbim psiko social

Mbështetja e nxënësve nga familjet në nevojë	2025–2028	sociale Njësia përgjegjëse për arsimin; Njësia përgjegjëse për shërbimet sociale	Shkollat, Njësitë Administrative, OJQ	Buxhet vendor + donacione + projekte sociale	Nr. i nxënësve (vajza/djem) nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel të mbështetur
Mbështetja e nxënësve me rezultate të shkëlqyera	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin; Njësia përgjegjëse për shërbimet sociale	MAS, mësues, komuniteti	Buxhet vendor + shpërblime nga MAS	Nr. i nxënësve (vajza/djem) me rezultate të shkëlqyera të mbështetur

Qëllimi 3 (Q3)– Zhvillimi i talenteve dhe ndjesisë së përkatësisë përmes veprimtarive jashtëmësimore

Objekti i veprimtarisë: Q3.1 Të organizohen rregullisht veprimtari kulturore, sportive dhe ndërgjegjëse, si: ngjarje artistike, ekspozita, ditë ndërkombëtare tematike, aktivitete mjedisore dhe lokale, për të nxitur zhvillimin e aftësive dhe pjesëmarrjen aktive të fëmijëve në jetën shoqërore.					
Aktivitetet	Periudha e zbatimit	Përgjegjësi	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
Organizimi i aktiviteteve kulturore, sportive, lojëra edukative dhe mbështetje emocionale në institucionet e Arsimit:					
1. 23–30 Shtator – Java Evropiane e Sportit					
- Loja sportive në oborrin e kopshtit (loja popullore) - Ushtrime në natyrë (gimnastikë) - Loja të ndryshme lëvizore, Gara me biçikleta, etj.)	Çdo vit	Shkollat /kopshte t	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje donatorësh	Numër dhe larmi aktivitete; përfshirje gjithëpërfshirëse;
2. Prill–Maj – Java Olimpikë					
- Loja të ndryshme sportive (stafeta me flamuj, topa) - Gara vrapimi, midis kopshteve në grupe - Gara me biçikleta					
3. 20 Nëntor – Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve					
- Bisedë, postera, aktivitete në natyrë (Kam të drejtë të luaj) - Ekspozitë me materiale të përgatitura nga fëmijët “Të drejtat e mia” “Unë mbrojt të drejtat e mia” (bisedë)					
4. Dita e Luftës Kundër Bullizmit (21 nëntor)					
Bisedë me fëmijët					
1. Dita e Alfabetit të Gjuhës Shqipe					
- Postera me gjuhën shqipe & ilustrime - Koncert për gjuhën shqipe (Gjuha jonë sa e mirë)					
2. Dita Ndërkombëtare e Drejtave të Personave me Aftësi të					

Kufizuara (3 dhjetor)										
✚	Biseda sensibilizuese për fëmijët me nevoja të veçanta									
✚	Loja me role (si t'i ndihmojmë shokët me nevoja të veçanta)									
✚	Ekspozitë me punime të përgatitura nga fëmijët me AK									
3. Dita Botërore e Gjuhës Amtare										
✚	Vizitë në bibliotekë									
4. Dita Botërore e Ujit (UNESCO 22 mars)										
✚	Rëndësia dhe vlerat e ujit (bisedë, prezantime)									
✚	“Uji është jetë” (Postera, eksperiment me ujëra)									
✚	Bisedë për vlerat e ujit									
5. Dita Ndërkombëtare e Romëve										
✚	Bisedë për fëmijët romë									
6. Zakonet dhe traditat e romëve										
7. Dita Botërore e Librit (23 prill)										
✚	Ne dimë të bëjmë libra (aktivitet krijues)									
✚	Vizitë në bibliotekë									
✚	Dhuro një libër, hap një dritare (fushatë sensibilizuese)									
8. Dita Botërore e Mjedisit (5 qershor)										
✚	Ekspozitë me mjete të riciklueshme									
✚	Mbrojmë tokën, planetin tonë (projekt)									
✚	Mbjellim lule në oborrin e kopshtit ose në vazo (aktivitet praktik)									
✚	Mbajmë pastër mjedisin ku mësojmë e luajmë (aktivitet praktik, bisedë)									
✚	Ekskursion në lulishten e qytetit									
9. Pedalo për Turizëm dhe Kulturë në bashkëpunim me QKF										
✚	Pedalim me biçikleta në pedonalen e qytetit									
✚	Ekspozitë me punime, vizatime dhe postera									

10. Yjet e Vallzimit në bashkëpunim me QKF ✚ Konkurs midis kopshteve të qytetit					
11. Pedalo Kuq e në bashkëpunim me QKF ✚ Marshim me biçikleta të fëmijëve të koipshtit me rastin e Festave Kombëtare					

8. Plani i investimeve kapitale

Lista e projekteve të investimeve për periudhën afatmesme 2026 -2028 (në mijë lekë)

Nr.	Emërtimi i Projektit	Viti 2025 (000 lekë)	Viti 2026 (000 lekë)	Viti 2027 (000 lekë)	Viti 2028 (000 lekë)	Totali (000 lekë)
1	Rikonstruksion i Ambjenteve Sportive	2,400	—	—	—	2,400
2	Rikonstruksion i terreneve sportive të shkollës "Jani Vreto", Leskovik	20,175	—	—	—	20,175
3	Rikonstruksion i konviktit	—	2,184	2,181	2,400	6,765
4	Hapja e kopshtit me drekë "Marie Gjergo"	7,262	—	—	—	7,262

9. Monitorimi dhe vlerësimi

Zbatimi efektiv i Planit të Arsimit Parauniversitar kërkon një sistem të qartë dhe të qëndrueshëm monitorimi dhe vlerësimi, që siguron ndjekjen sistematike të progresit dhe ofron bazën për përmirësime të vazhdueshme. Ky sistem është i lidhur ngushtë me objektivat dhe aktivitetet e planit të veprimit dhe mbështetet në të dhëna të verifikueshme, pjesëmarrje të aktorëve dhe transparencë institucionale.

Indikatorët e Performancës

Indikatorët e performancës janë të përqendruar në vlerësimin e rezultateve të arritura në raport me objektivat strategjikë. Ata janë të ndërlidhur me çdo kategori aktiviteteesh në planin e veprimit dhe do të përdoren për matjen e progresit të përvitshëm. Këta përfshijnë:

- Numrin e institucioneve të rikonstruara ose me kushte të përmirësuara;
- Numrin i kopshteve (hapësirave) të reja funksionale;
- Rritjen e regjistrimeve në kopshte dhe përfshirjen e fëmijëve nga grupe në nevojë;
- Numrin e mësuesve dhe edukatorëve të trajnuar;
- Cilësinë e mësimdhënies dhe përdorimin e mjeteve didaktike dhe teknologjisë;
- Numrin e aktiviteteve jashtëmësimore dhe pjesëmarrjen e fëmijëve në to;
- Mbështetjen sociale për fëmijët në nevojë (ushqim, mjete, shërbime psiko-sociale);
- Eficienca në furnizim, mirëmbajtje dhe shërbime mbështetëse.

Planifikimi i vlerësimit të progresit

Progresi i planit do të vlerësohet përmes mekanizmave të strukturuar të raportimit dhe analizës, të cilët do të jenë të integruar në ciklin e planifikimit buxhetor dhe vendimmarrjes vendore. Vlerësimi do të përfshijë:

- Raportime vjetore mbi realizimin e aktiviteteve të planifikuara;
- Matjen e ndikimit të investimeve në infrastrukturë dhe cilësi shërbimi;
- Analizën e të dhënave të mbledhura përmes monitorimit në terren;
- Vlerësimin e përmirësimit të qasjes, përfshirjes dhe mjedisit të të nxëniet;
- Ndërlidhjen e progresit me planifikimin e ardhshëm afatmesëm.

Përfshirja e aktorëve të jashtëm

Për të garantuar objektivitetin, transparencën dhe përmirësimin e vazhdueshëm, do të sigurohet përfshirja aktive e aktorëve të jashtëm, si:

- Ekspertë të pavarur në fushën e arsimit, të ftuar për të kryer vlerësime tematike;
- Organizata joqeveritare që merren me cilësinë e arsimit dhe përfshirjen sociale;
- Këshillat e prindërve, drejtuesit e shkollave dhe komunitetet vendore;
- Njësitë e statistikës/performances dhe monitorimit të bashkisë për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave;
- Partnerë ndërkombëtarë në kuadër të projekteve të mbështetura financiarisht.

Metodologjia e monitorimit dhe vlerësimit

Monitorimi i planit do të realizohet në dy drejtime kryesore:

1. **Monitorimi i nivelit të realizimit të aktiviteteve të planifikuara**
2. **Vlerësimi i ndikimit të aktiviteteve në komunitetin arsimor**

Monitorimi i realizimit të aktiviteteve

Çdo aktivitet i planit do të vlerësohet në bazë të një sistemi pikëzimi nga 0 deri në 10, ku:

- **0** – Aktiviteti nuk ka nisur.
- **1-9** – Aktiviteti është pjesërisht i realizuar, në varësi të nivelit të zbatimit.

- 10 – Aktiviteti është realizuar plotësisht sipas planifikimit.

Për secilin objektiv strategjik të planit, do të përcaktohet numri total i pikëve maksimale, duke shumëzuar numrin e aktiviteteve të planifikuara për objektivin përkatës me 10 (p.sh., 5 aktivitete x 10 = 50 pikë maksimale për objektivin).

Gjatë zbatimit, pikët reale të arritura për çdo aktivitet do të regjistrohen, dhe më pas do të përmbledhen në nivel objektiv. Kjo do të mundësojë llogaritjen e përqindjes së realizimit të secilit objektiv në kohë reale:

Perqindja e realizimit të objektivit = (Pike të realizuara / Pike maksimale) × 100

Ky mekanizëm do të sigurojë një vlerësim të qartë, të matshëm dhe të krahasueshëm për zbatimin e planit përgjatë viteve.

Vlerësimi i ndikimit në komunitet

Për të matur ndikimin e aktiviteteve në komunitet, do të monitorohet shkalla e pjesëmarrjes së institucioneve arsimore dhe fëmijëve në zbatimin e tyre.

Për çdo aktivitet do të vendosen targete të matshme:

- Numri i kopshteve dhe shkollave të synuara.
- Numri i fëmijëve të parashikuar për përfshirje (në kopsht dhe shkollë, sipas rastit).

Në përfundim të zbatimit të çdo aktiviteti, do të regjistrohet:

- Numri real i institucioneve që morën pjesë (në kopsht ose shkollë).
- Numri real i fëmijëve të përfshirë.

Në rastet kur aktiviteti synon vetëm një kategori (p.sh. vetëm kopshtet), pjesëmarrja për kategorinë tjetër do të konsiderohet 0.

Për çdo aktivitet do të llogaritet përqindja e pjesëmarrjes së arritur sipas formulës:

Perqindja e pjesëmarrjes = (Numri real i pjesëmarrësve / Numri target) × 100

Ky tregues do të ndihmojë në vlerësimin e shkallës së përfshirjes dhe impaktit që ka pasur secili aktivitet në komunitetin arsimor.

10. Rishikimi dhe përshtatja e planit

Rishikimi dhe përshtatja e planit janë mekanizma thelbësorë për të siguruar vazhdimësinë, qëndrueshmërinë dhe efektivitetin e ndërhyrjeve të planifikuara në fushën e arsimit parauniversitar në Bashkinë Kolonjë. Këto procese shërbejnë për të ruajtur koherencën midis objektivave të planit, nevojave reale në terren dhe zhvillimeve të reja institucionale, ligjore apo sociale.

Procesi i rishikimit

Rishikimi i planit do të bëhet në mënyrë të strukturuar dhe të paracaktuar, me qëllim që të vlerësohet në mënyrë periodike efektiviteti i masave dhe aktiviteteve të ndërmarra. Planifikohen këto forma rishikimi:

- **Rishikimi vjetor** – i fokusuar në përditësimin e planit të veprimit dhe buxhetit vjetor në funksion të rezultateve dhe ndryshimeve të kontekstit;
- **Rishikimi afatmesëm (në fund të vitit 2027)** – për të analizuar realizimin e objektivave strategjike, performancën e indikatorëve dhe për të orientuar masat për vitin 2028;

- **Rishikime të jashtëzakonshme**, në rast të ndryshimeve madhore (si reformë e kuadrit ligjor, emergjenca, ndryshime buxhetore të rëndësishme). Ky proces do të kryhet në mënyrë të ndërsektoriale, me pjesëmarrjen e drejtorive përgjegjëse, përfaqësuesve të institucioneve arsimore dhe aktorëve të tjerë vendorë.

Përshtatja e masave dhe aktiviteteve

Bazuar në të dhënat që rezultojnë nga monitorimi dhe vlerësimi i planit, si dhe në konsultimet me komunitetin arsimor, do të ndërmerren përshtatje të nevojshme në:

- **Aktivitete konkrete** – duke përmirësuar përmbajtjen, kohëzgjatjen, mënyrën e zbatimit apo përgjegjësit;
- **Alokimin e burimeve** – në rast se disa fusha kërkojnë më shumë mbështetje për të arritur objektivat;
- **Prioritetet vjetore** – në përputhje me nevojat emergjente të fëmijëve, stafit arsimor apo komunitetit lokal;
- **Metodologjinë e zbatimit** – duke integruar praktikat më të mira dhe rekomandimet e vlerësimeve të jashtme.

Ky fleksibilitet në përshtatje synon të sigurojë që plani të mos mbetet një dokument statik, por të jetë një instrument dinamik, funksional dhe i orientuar drejt rezultateve reale për përmirësimin e arsimit parauniversitar në Bashkinë Kolonjë.

11. Raportimi dhe transparencia

Zbatimi i Planit të Arsimit Parauniversitar do të shoqërohet me mekanizma të qartë raportimi dhe transparence, për të garantuar përgjegjshmëri institucionale dhe përfshirje qytetare në vlerësimin e progresit.

- **Raportimi i progresit** do të realizohet përmes raporteve periodike vjetore, të cilat do të përfshijnë ecurinë e zbatimit të objektivave, sfidat e hasura dhe masat korrigjuese të ndërmarra nga njësitë përkatëse.
- **Përfshirja e publikut** do të sigurohet përmes publikimit të raporteve dhe rezultateve në faqen zyrtare të bashkisë, organizimit të takimeve konsultative me komunitetin dhe mundësimin të pjesëmarrjes qytetare në propozimin dhe vlerësimin e masave për përmirësimin e sistemit arsimor.

12. Aneks 1: Kuadri Ligjor dhe nënligjor për Arsimin Parauniversitar

Kuadri Kushtetues dhe Ligjor i përgjithshëm

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 57, pika 1
- Ligji Nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 48/2018
- Ligji Nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen 0Vendore”
- Ligji Nr. 9936/2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji Nr. 68/2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”
- Ligji Nr. 9632/2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar

Arsimi Parashkollor dhe i detyrueshëm (Bazë)

- Urdhër nr. 31, datë 28.01.2020, “Për miratimin e Rregullores për Funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare”
- Udhëzim Nr. 14, datë 10.7.2023, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore në arsimin parauniversitar”
- Udhëzim i përbashkët MAS–MEKI nr. 13, datë 10.07.2024, “Për vitin shkollor 2024–2025 në sistemin arsimor parauniversitar”
- Udhëzim Nr. 25, datë 25.07.2018, “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”
- Urdhër nr. 199, datë 07.05.2024, “Për miratimin e Kornizës së vlerësimit të cilësisë së kopshtit”

Përfshirja dhe mbrojtja e fëmijëve

- Ligji Nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji Nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”
- Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve, 2021–2025
- Udhëzim Nr. 21, datë 08.08.2014, “Për rritjen e frekuencimit të arsimit parashkollor nga fëmijët romë”
- Udhëzim i përbashkët MAS–MShMS nr. 658, datë 23.09.2019, “Për mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme në internet”

Shërbimi psiko-Social dhe ërfshirja Sociale

- Urdhër nr. 313, datë 20.10.2020, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar”
- Udhëzuesi për Praktikën e Punës së Shërbimit Psiko-Social Shkollor, për punonjësit e ZVA-ve dhe strukturat arsimore vendore